



BULETINI

QERSHOR 2025



Gjatë qershorit 2025, ACDC zbatoi një sërë aktiviteteve që synonin përmirësimin e të drejtave institucionale të komuniteteve jo-shumicë, promovimin e të drejtave të njeriut dhe inkurajimin e dialogut publik mbi çështjet kryesore sociale.

Përmes organizimit të tryezave të rrumbullakëta dhe konferencave, u hapën tema të rëndësishme si qasja në konsultime publike, punësimi në institucione, pengesat në profesionet e lira ligjore, si dhe të drejtat e komunitetit LGBTQI+.

Muaji u përmbyll me një ngjarje artistike që kontribuoi në dukshmërinë e temave të marginalizuara përmes shprehjes krijuese.



Konferencë mbi punësimin e pjesëtarëve të komunitetit serb në institucionet kosovare

Më 24 qershor 2025, ACDC organizoi konferencën kushtuar sfidave të punësimit të serbëve në institucionet e Kosovës, me një fokus të veçantë në të drejtat institucionale të komuniteteve jo-shumicë. Gjatë kësaj ngjarje, u prezantuan gjetjet e hulumtimit që tregojnë një nivel të ulët interesi për punësim në institucione, veçanërisht në nivel qendror, i cili lidhet me rrethanat politike, presionet sociale dhe barrierat administrative. Pjesëmarrësit diskutuan masat e nevojshme që do të kontribuonin në një integrim më të madh dhe mundësi të barabarta për të gjithë qytetarët.



Konferencë mbi qasjen e komuniteteve joshumicë në profesionet juridike

Në Qendrën për Energji Qytetare në Mitrovicën e Veriut, më 26 qershor 2025, organizata ACDC organizoi një konferencë të dedikuar për përfshirjen e komuniteteve jo-shumicë në profesionet e lira juridike në Kosovë. Ngjarja mbledhi përfaqësues të institucioneve të drejtësisë, komunitetit ndërkombëtar, shoqërisë civile dhe profesionistëve juridikë, me qëllim të prezantimit të gjetjeve nga hulumtimi dhe hapjes së diskutimit mbi sfidat dhe mundësitë për përfaqësim më të madh të komuniteteve jo-shumicë – kryesisht serbëve – në profesionet e noterëve, avokatëve dhe përmbaruesve.




Diskutim për pezullimin e pagesës së shtesave për fëmijë në Mitrovicën e Veriut
 Pezullimi i pagesave të ndihmës për fëmijë për qindra familje në Kosovë ishte tema e një tryeze të rrumbullakët të organizuar nga ACDC më 12 qershor 2025 në veri të qytetit të Mitrovicës. Pjesëmarrësit kanë vënë në pah një sërë problemesh - nga procedurat e paqarta të verifikimit të vendbanimit deri te dështimet teknike dhe administrative gjatë regjistrimit të popullsisë. Diskutimi hapi çështje të mospërputhjes në zbatimin e kriterëve, informacionit të paarrtshëm dhe komunikimit të vështirë me institucionet kompetente. Qëllimi i kësaj ngjarje ishte të kontribuonte në kuptimin e shkakut të problemit përmes dialogut dhe të fillonte iniciativa për zgjidhjen e tij institucionale.



Tryezë e rrumbullakët në Gjilan - Platformë për konsultime publike dhe të drejtat e komuniteteve jo-shumicë

Më 3 qershor 2025, OJQ ACDC organizoi tryezë të rrumbullakët në Gjilan kushtuar rolit të një platforme për konsultime publike në mbrojtjen e të drejtave të grupeve cënueshme dhe grupeve jo-shumicë. Gjatë këtij aktiviteti, u diskutuan mekanizmat për përfshirjen e qytetarëve në proceset e vendimmarrjes, disponueshmëria e informacionit në gjuhët e komuniteteve, si dhe mënyrat për të forcuar transparencën dhe llogaridhënien e institucioneve.



Në fund të qershorit, më 30 qershor 2025, në kuadër të projektit "Sjellja e Krenarisë në Veri", ACDC organizoi aktivitetin artistik në ambientet e Shtëpisë së Evropës në veri të Mitrovicës. Aktiviteti mbledhi së bashku veprat e shtatë artistëve të cilët, përmes instalacioneve, botimeve dhe veprave artistike, trajtuan temat e identitetit, përkatësisë dhe lirisë së shprehjes. Qëllimi i aktivitetit ishte të inkurajonte dialogun në komunitetin lokal përmes artit, të hapte një hapësirë për të kuptuar diversitetin dhe të kontribuonte në dukshmërinë e temave LGBTQI+.



Letër e hapur lidhur me praktikën e MPB-së së Kosovës

Organizatat joqeveritare nga komuniteti serb në Kosovë kanë shprehur shqetësimin e tyre lidhur me deportimet e fundit të qytetarëve me banim të përhershëm në Kosovë, të cilët posedojnë shtetësi të dyfishtë – të Kosovës dhe Serbisë – gjë që është në përputhje me Kushtetutën dhe ligjet e Kosovës.

SRB

ENG

ALB

ACDC në medijima


Dushan Radaković, drejtor ekzekutiv i ACDC, për Gorazdevac.com - rreth padukshmërisë së të rinjve pa dokumente



Aleksandar Rapajić, drejtor programi në ACDC, për Radio Kontakt Plus - rreth mospërputhjes midis regjistrimit të popullsisë dhe listave të votuesve



Ines Aljović Mihajlović, zyrtare programi në ACDC, për Kosovo Online - rreth heqjes së shtesave për fëmijë



KONTAKT

✉ office@acdc-kosovo.org

📷 [@acdc.kosovo](https://www.instagram.com/acdc.kosovo)

f www.facebook.com/Ngoacdc

✂ [@ngo_acdc](https://www.x.com/ngo_acdc)

www.acdc-kosovo.org